



MAJ 2021



TITUJT

Editorial: Ndërgjegjësimi mjedisor **faqja 1**

COVID-19: Përgjigje dhe aktivitete të tjera të KB **faqet 2 и 3**

Programet e përbashkëta të OKB-së & Në fokus **faqja 4**

DATAT KYÇE

MAJ

11 UNODC morri pjesë në një takim koordinues të donatorëve për sundimin e ligjit, për ta diskutuar bashkëpunimin e mundshëm dhe për ta shmangur dyfishimin e punës së projektit, si dhe për t'i njohur familjarët e interesuar me aktivitetet e Programit Rajonal të UNODC-së për Evropën Juglindore në vend

11 UNODC morri pjesë në takimin e parë të asamblesë së përgjithshme hibride "Bashkëpunimi policor rajonal i shëfave të policisë të Evropës Juglindore në luftimin e krimit të organizuar transnacional (SEPCA)"

21-22 HERA e realizon serinë e katër të trajnimeve për ofruesit e specializuar të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës ndaj grave. Trajnimet janë pjesë e projektit rajonal të OKB-së për Gratë "Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve", financuar nga Bashkimi Evropian

25 Dialogu rajonal "Çështjet e politikës dhe qeverisjes për transformim të sistemeve ushqimore në Evropë dhe Azinë Qendrore," të organizuar nga Koalicioni i OKB-së i bazuar në çështje mbi Sistemet e Qëndrueshme të Ushqimit për Evropën dhe Azinë Qendrore, kryesuar nga FAO, UNICEF dhe DBSH, në vigjilje të Samitit të OKB-së mbi Sistemet Ushqimore, që do të zhvillohet shtator, 2021

27-28 HOPS - Projekti i Mundësive të Shëndetshme Shkup, në partneritet me Koalicionin Margjesh dhe Rrjetin nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje realizon trajnime në internet për punonjësit e mediave jashtë Shkupit mbi dhunën e bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave. Trajnimet janë pjesë e projektit rajonal të OKB-së për Gratë "Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve", financuar nga Bashkimi Evropian

EDITORIAL Koordinator i përhershëm i OKB-së

Viti i kaluar na e përkujtoi rëndësinë e shëndetit, por gjithashtu e ngriti vetëdijen e shoqërive tona ndaj mjedisit jetësor dhe e vuri në pah marrëdhënien e ndërlikuar ndërmjet ndikimit tonë ndaj mjedisit dhe vetë shëndetit tonë.

Në përpjekje për t'u larguar nga rajonet e mbipopulluar, ora policore dhe kufizimet që impononte jeta në qytet gjatë pandemisë, shumë qytetarë - veçanërisht familjet e reja - e zvendësuan jetën urbane të Shkupit, Manastirit, Kumanovës dhe të qyteteve tjera me rehatinë dhe qetësinë e fshatrave të largëta, ku zakonisht kishin jetuar gjyshërit e tyre. Shumë prej këtyre familjeve kërkuar ilaçe natyrore, për ta përmirësuar shëndetin dhe imunitetin, veçanërisht me produktet e bletëve, bimëve dhe barërave bimore, madje disa ishin dhënë pas dobive të produkteve krejtësisht natyrale të qumështit. Të tjerët thjesht donin t'i shpëtonin stresit të pandemisë, të merrnin frymë pa maskë, të jenë të fshehur dhe të mbrojtur në mënyrë të sigurt nga një ushtri pemësh dhe shkurresh.

Ne i drejtohem natyrës sa herë që jemi në ankth, por a bëjmë aq sa duhet për ta mbrojtur atë?

Përderisa po përmirësohet situata rreth pandemisë, Shkupi mbetet në krye të listës së qyteteve me ajër të ndotur gjatë dimrit në raport me qytetet në rajon. Ndotja e Vardarit, lumenjve dhe liqeneve tjerë nga industritë dhe individët e papërgjegjshëm mbetet konstante. Vodno, hapësira më e madhe në Shkup për largim gjatë fundjavës nga zona urbane, vazhdon të vuajë për shkak të planifikimit të dobët urban dhe mijëra "alpinistëve", që nuk u intereson se ku do ta hedhin shishen plastike të ujit pasi ta shuajnë etjen. Po ashtu edhe liqeni i Ohrit, një nga monumentet e këtij vendi të bukur, po mbytet në kaosin urban të ndërtimeve të paligjshme të dekadave të kaluara, me çka rrezikohet të dëmtohet kultura dhe historia e ndërtuar ndër shekuj.

Veprimi për klimën dhe vetëdija ndaj mjedisit jetësor janë rritur në mënyrë drastike në dekadën e fundit si në nivelin lokal, po ashtu edhe në atë global, mirëpo ende nuk ka arritur ndryshimi i dukshëm që e pasqyron ndikimin pozitiv në planetin tonë. Ka shumë arsye për këtë dhe nuk ka zgjidhje të lehta, mirëpo ekziston një mungesë e të kuptuarit të ndikimit të veprimeve tona individuale. Kjo duhet të adresohet

urgjentisht.

Së pari, ne duhet t'ua bëjmë me dije të gjithëve se sa i rëndësishëm është mjedisi ynë për shëndetin dhe cilësinë e jetës së bashkësive tona. Së dyti, ne duhet të mbjellim mirëkuptimin se veprimi mjedisor është një mundësi dhe investim në veten tonë, një mjet që mund të na ndihmojë ta luftojmë varfërinë dhe pabarazinë, duke e rritur punësimin dhe fuqizuar ekonominë. Së treti, veprimi i TË GJITHËVE ka rëndësi dhe të gjithë mund të marrin masa. Në fakt, nëse mbështetet me investime të duhura dhe me infrastrukturë të nevojshme, përqendrimi i shtuar dhe jetesa në zonat rurale mund të kontribuojë ndjeshëm në një zhvillim më të mirë, më të drejtë dhe të qëndrueshëm. Veprimi për të ndihmuar në rikuperimin dhe ruajtjen e planetit, mund të jetë një veprim i thjeshtë individual, qoftë përmes përvetësimit të një mënyrë të të ushqyerit të pasur me bimë, hapjes së një kopshti urban, mbjelljes së ndonjë peme ose pastrimit të natyrës përreth nesh. Ulja e konsumit të produkteve me një përdorim të vetëm ose zvogëlimi i mbeturinave të ushqimit është një kontribut i thjeshtë por me ndikim qenësor.

Duke filluar nga ata që janë të autorizuar të miratojnë ose vënë në zbatim ligje për mbrojtje të mjedisit jetësor, te ata që i zbatojnë dhe kontrollojnë politikatat dhe projektet infrastrukturale dhe ata që rrallë mendojnë për ndikimin që kanë insektet e vogla - si bletët - në shëndetin tonë, ose janë shumë të lodhur për ta mbajtur një shishe plastike sapo të zbrazet, TË GJITHË duhet të veprojme, për hir të të gjithë neve.

Rosana Duxhak
Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Maqedoninë e Veriut



AKTIVITETET E PËRGJIGJES DHE RIMËKËMBJES NGA KOVID-19

Agjencitë e OKB-së vazhdojnë ta mbështesin përgjigjen ndaj KOVID-19 në vend, me ndërhyrje specifike dhe analiza të thelluara, të përqendruara në çështje brenda fushave të tyre përkatëse të ekspertizës.

Pandemia është karakterizuar nga raste të shkeljes së të drejtave të punëtorëve. **Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)** i dalloi përpjekjet e Federatës së Sindikatave të Maqedonisë (FSM) për të mbrojtur dhe vepruar në emër të këtyre punëtorëve dhe e mbështeti FSM-në në zhvillimin e një aplikacioni celular për raportimin e çdo lloji të shkeljes së të drejtave të punës. ILO gjithashtu e mbështeti krijimin e një mekanizmi për referimin zyrtar të rasteve nga FSM-ja te Inspektorati Shtetëror i Punës për procedim të mëtejshëm. Aplikacioni SSM - Moi rabotnicki prava (Të drejtat e mia si punëtor) është në dispozicion për **Android** dhe **iOS**.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe ILO i përgatitën udhëzimet e përkohshme për shëndetin dhe sigurinë në punë për mbrojtje nga KOVID-19 dedikuar punëtorëve shëndetësorë ([linku](#) në anglisht), që u përkthye në **maqedonisht**. Përveç masave të shëndetit dhe sigurisë në punë për punëtorët shëndetësorë dhe shërbimet e shëndetit në punë në kontekstin e pandemisë, udhëzimi gjithashtu i përshkruan të drejtat dhe përgjegjësitë për shëndetin dhe sigurinë në punë për punonjësit shëndetësorë sipas standardeve të ILO-s. Dokumenti iu dedikohet punëdhënësve dhe menaxherëve të institucioneve shëndetësore, punonjëseve shëndetësorë dhe përfaqësuesve të tyre, ekspertëve të shëndetit dhe sigurisë në punë, ekspertëve për parandalim dhe kontroll të infeksioneve në institucionet shëndetësore publike dhe private si dhe politikëbërësve.

Zyra e OKB-së për sërbbime të projekteve (UNOPS) e filloi zbatimin e projektit të financuar nga Banka Botërore Përgjigja emergjente e Maqedonisë së Veriut ndaj KOVID-19 (4.3 milionë euro). Deri në shtator të vitit 2021, projekti do ta mbështesë rritjen e kapacitetit operativ të Ministrisë së Shëndetësisë përmes sigurimit të pajisjeve specifike mjekësore dhe trajnimit të përdoruesve të tyre, si dhe përmes kësaj do të kontribuojë në forcimin e sistemit nacional të gatishmërisë së shëndetit publik.

Në muajin maj, **Maqedonia e Veriut e pranoi dërgesën e dytë KOVAKS të vaksinave kundër KOVID-19**, duke e çuar numrin e përgjithshëm të vaksinave të siguruar nga KOVAKS në 62,400. Maqedonia e Veriut është një nga vendet dhe ekonomitë, që me vetëfinancim marrin pjesë në mekanizmin KOVAKS, i cili e përdor rjetin global të furnizimit dhe logjistikës të **Fondit të OKB-së për Fëmijë (UNICEF)** për ta mbështetur prokurimin dhe shpërndarjen e vaksinave.

UNICEF dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale i **bashkuan përpjekjet e tyre për ta nxjerrë në pah rëndësinë e mbështetjes së familjeve, për ta siguruar kujdesin përfundimtar dhe për t'i mbështetur nevojat e fëmijëve** për t'u rritur dhe zhvilluar mirëfillt gjatë gjithë jetës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme gjatë pandemisë KOVID-19 pasi që familjet përpiqen me vështirësi t'i shtyjnë fëmijët e tyre të mësojnë, si dhe shtojnë që familjet e tyre të jenë funksionale. Partnerët në fjalë e rigjallëruan përkushtimin e tyre për ta vazhduar punën së bashku, me qëllim që ta mbrojnë të drejtën e çdo fëmije të rritet në një mjedis familjar të favorshëm. Kjo përfshin sigurimin që të përmbushen interesat më të mira të secilit fëmijë, duke u mbrojtur nga ndarja e panevojshme nga familjet: parandalimi i ndarjes familjare përmes programeve për familjet më të rrezikuara për ta kapur ndonjë problem para se të përshkallëzohet, dhe zhvillimin e shërbimeve me bazë në komunitet për t'i ndihmuar familjet të qëndrojnë së bashku. Gjithashtu bashkëpunimi i këllillë e përfshin punën për ta rritur cilësinë e kujdesit të bazuar në familje, ose të kujdesit alternativ të ngjashëm me familjen, për fëmijët që janë tashmë nën kujdes, si dhe kthimin e fëmijëve në familjet e tyre ose gjetjen e zgjidhjeve tjera të përhershme të bazuara në familje.

Më 19 maj OBSH-ja organizoi një trajnim të trajnuesve për zbulimin e kontaktit me KOVID-19 për 20 epidemiologë. Gjurmimi i kontaktit është element kryesor për ta kontrolluar përhapjen e KOVID-19, duke e ndërprerë zinxhirin e transmetimit nga një person te tjetri.

Më 26 maj, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë, OBSH-ja e organizoi një dialog politik: "Pabarazia shëndetësore dhe KOVID-19 në Maqedoninë e Veriut: Investimi në shëndetin dhe mirëqenjen për një të ardhme më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë". Dialogu i politikave u organizua si një ngjarje përmblyëse e fushatës së Ditës Botërore të Shëndetit 2021 mbi pabarazitë shëndetësore (Ndërtimi i një bote më të drejtë dhe më të shëndetshme).

Në maj, OBSH-ja i dhuroi Ministrisë së Shëndetësisë/ Institutit të Shëndetit Publik pajisje mbrojtëse personale dhe mjete për diagnostikim për të mbështetur reagimin shtetëror të Maqedonisë së Veriut ndaj KOVID-19, duke përfshirë mantela, mburoja të fytirës, syze mbrojtëse dhe çanta me pajisje bio - të rrezikshme për punonjësit shëndetësorë të linjës së parë. Donacioni, me vlerë prej 54,000 dollarë, gjithashtu përfshiu 15,000 mostra koleksionesh kutive të veglave, 12,000 teste manuale për PCR, një sistem pastrimi dhe një sistem PCR në kohë reale që do t'i forcojë kapacitetet nacionale të testimit.

Për t'u përgjigjur nevojës për mbështetje të funksionalitetit të moduleve të sapo zhvilluara të imunizimit, si pjesë e projektit Fondi i Mirëbesimit me shumë Partnerë, u azhurnuan kapacitetet e sistemit harduer të drejtorisë së shëndetit elektronik. OBSH në Maqedoninë e Veriut e ka siguruar deponimin e këtyre të dhënave, duke pasur parasysh se një nga përparësitë strategjike të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për mirëmbajtjen e shërbimeve thelbësore shëndetësore është krijimi i një sistemi funksional elektronik të imunizimit dhe rritja e kapaciteteve të tij në përputhje me nevojat e sapo zhvilluara kundër KOVID-19.

OBSH-ja, Ministria e Shëndetësisë dhe UNICEF-i u bashkëpunuan për ta vëzhguar Javën Evropiane të Imunizimit në Maqedoninë e Veriut, duke e theksuar rëndësinë e mirëmbajtjes së vaksinimit rutinë dhe fitimin e besimit të publikut për sigurinë dhe efikasitetin e vaksinave kundër KOVID-19. OBSH-ja dhe partnerët i theksuan mënyrat e

shumta, në të cilat vaksinat na mundësojnë të jetojmë jetë të shëndetshme dhe produktive duke parandaluar përhapjen e sëmundjeve të parandalueshme nga vaksinat.

Më 10 maj, Dr Xhahane Tavilah, Përfaqësues i OBSH-së në Maqedoninë e Veriut e vizitoi Spitalin e Specializuar për Mjekësinë Gjeriatrie dhe Paliative "13 Nëntori" në Shkup. Gjatë vizitës në terren, së bashku me ekipin e spitalit ata diskutuan për rëndësinë e kujdesit multidisiplinar për të moshuarit, që janë ndër më të prekshmit ndaj KOVID-19

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

Gjatë iniciativës "**Mësim për Planetin**", me rastin e shënimit të Ditës së Tokës të organizuar nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe mbështetur nga UNICEF-i, 1,160 mësues dhe 34,304 nxënës morën pjesë në aktivitete mësimore mbi ndryshimin e klimës dhe veprimin për klimën.

UNICEF-i promovoi një **seri videosh** ku shfaqen operatorët e linjës së ndihmës për prindërit, duke ofruar këshilla të shkurtra për prindërit mbi teknikat pozitive të prindërimit. Temat lëvizin nga metodat praktike pozitive të prindërimit, pasojat në rast të përdorimit të disiplinimit fizik, prindërimi i adoleshentëve, zhvillimi socio-emocional, deri te mënyra e trajtimit të stresit gjatë krizës dhe higjiena mendore e prindërve dhe kujdestarëve.

UNICEF-i e nisi një partneritet të ripërtërirë me Fondin për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik (FITD) për ta vazhduar mbështetjen për sipërmarrjen sociale të të rinjve - përmes programit UPSHIFT - një iniciativë për të angazhuar të rinjtë e moshës 13 deri në 19 vjeçare për të hartuar zgjidhje inovative për problemet sociale që ata kanë identifikuar në bashkësitë e tyre. Gjatë tre viteve të ardhshme partnerët do të punojnë me të rinjtë për të zhvilluar eko-zgjidhje për sfidat në mjedis dhe ndryshimet klimatike.

Falë partneritetit ndërmjet UNICEF-it dhe Platformës në internet Hapni Dritaret, tetëdhjetë profesionistë nga qendrat e kujdesit ditor, kopshtet dhe qendrat për punë sociale dhe vetëqeverisjet lokale u trajnuan se si ta përdorin Platformën në internet Hapni Dritaret në sigurimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara me mbështetje të individualizuar. Këta profesionistë do ta sigurojnë shkallëzimin dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimit në internet, në mbështetje të familjeve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, që nuk kanë mundësinë të marrin shërbime nga një edukator special dhe rehabilitues në vendbanimin e tyre.

Në bashkëpunim me Shoqatën Infermierëve dhe Mamive të Maqedonisë së Veriut, UNICEF-i zhvilloi 15 trajnime mbi këshillimin themelor psiko-social në mars-prill 2021, për zhvillimin e kapacitetit të 200 infermierëve vizitorë në shtëpi (motra të patronazhit) në mbështetjen themelore psiko-sociale për familjet me gra shtatzëna dhe nënat me foshnja të sapolindura.

Gjatë majit dhe qershorit, si pjesë e shtrirjes nacionale të programit të mësimi shoqëror dhe emocional në ente parashkollëre, UNICEF-i mbështet një seri trajnimesh për ndërtimin e kapaciteteve për 280 edukatorë të rinj parashkollëre. Trajnimet do t'i njoftojnë edukatorët e enteve parashkollëre me neuroshkencën, që e mbështet themelin e të mësuarit shoqëror dhe emocional, efektet e stresit dhe

LATEST EPIDEMIOLOGICAL DATA (9 June 2021)

155,418 CONFIRMED COVID-19 CASES
270,135 VACCINE DOSES ADMINISTERED

5,458 COVID-19-RELATED FATALITIES

Weekly new cases reported



Weekly deaths reported



For latest data see covid19.who.int/region/euro/country/mk

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË (vazhdojnë)

fatkeqësisë të fëmijët, si dhe strategjitë e ndryshme për të ndërtuar aftësi shoqërore dhe emocionale si të fëmijët ashtu edhe të edukatorët. Mësimi social dhe emocional është veçanërisht i rëndësishëm gjatë pandemisë Kovid-19, pasi e mbështet shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve, duke i ndihmuar fëmijët të përballen me pasigurinë, t'i rregullojnë emocionet e tyre dhe të përballen me rrethanat e papritura dhe të vështira.

Fondi i OKB-së për Popullsisë (UNFPA) e mbështet Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale në zhvillimin e akteve nënligjore për ligjin e ri mbi parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ligji ka hyrë në fuqi në 6 maj 2021.

Organizata e OKB-së për Ushqim dhe Bujqësisë (FAO) e ka filluar zbatimin e një projekti rajonal, që synon krijimin e mjediseve të mundshme për rritjen e qëndrueshmërisë së klimës në bujqësi përmes forcimit të sistemit të farës në vend dhe promovimit të farërave cilësorë të varieteteve tolerante ndaj klimës. Në partneritet me Institutin e Bujqësisë në Shkup, FAO aktualisht organizon prova demonstruese për shumëzimin e materialit të farës nga varietetet e zgjedhura të kulturave bimore, për ta vlerësuar ndikimin e ndryshimit të klimës ndaj prodhimit në kushte të ndryshme, si dhe efektet e zbatimit të masave të ndryshme bujqësore dhe teknike, për ta rritur rezistencën e llojeve të kultivuara ndaj ndryshimeve klimatike. Qëllimi përfundimtar i këtyre aktiviteteve është marrja e materialit cilësor të farës, i cili do të jetë më i disponueshëm për shpërndarje te fermerët.

Në kuadër të projektit **MAINLAND** të financuar nga BE-FAO, konsolidimi i tokës është avancuar në nëntë zona të projektit. Projekti i parë i shumicës së tokës së konsoliduar në vend - **fshati Egri** (Komuna e Manastirit) - u regjistrua zyrtarisht në Kadastrën e Pasurive të Patundshme. Kjo do të rezultojë që 214 pronarë tokë në Egri të marrin emra të rinj pronësie dhe do ta fillojnë sezonin bujqësor në parcelat e tyre të sapo konsoliduara të tokës, që lejojnë praktika më të mira dhe më efikase të bujqësisë. Me konsolidimin e tokës, numri i parcelave të tokës në Egri u zvogëlua për gati katër herë, nga 874 parcela në 260, me një madhësi mesatare prej 1.30 hektarë (nga 0.38 hektarë më parë). Konsolidimi i tokës në Egri përfshin gjithashtu investime në përmirësime të infrastrukturës bujqësore të tilla si ndërtimi i kanaleve kulluese, shtrirja e rrjetit ekzistues të ujitjes dhe ndërtimi i rrugëve me zhavorr që pritet të finalizohen deri në fund të vitit 2021.

Si pjesë e projektit të FAO-s për bashkëpunim teknik "Mbështetja për Zhvillimin e Integruar të Komunitetit Lokal", FAO ka zbatuar veprime të bazuara në komunitet në disa zona pilot. Njëra prej tyre është rinovimi i vazhdueshëm i shtëpisë kulturore me shumë qëllime në fshatin Spançevë, i cili synon t'i u shërbejë nevojave shoqërore, kulturore dhe qeverisëse të fshatrave Spançevë, Sokolarcë dhe Çesinovë (Komuna e Koçanit). Njëkohësisht, shkolla komunale e vendosur në fshatin Sokolarcë do të merr pajisje moderne të ndriçimit, duke e vënë oborrin e shkollës dhe fushën e futbollit në përdorim të gjerë për fëmijët dhe të gjithë komunitetin. Veprimet e ngjashme pilot do të fillojnë në muajt e ardhshëm në komunitetin e dytë pilot të Manastirit, të përbërë nga fshatrat Egri, Zhabeni dhe Optičari. Këto veprime janë në sinergji me punën e vazhdueshme të FAO-s për konsolidimin e tokës në të njëjtat zona, ku FAO dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave punojnë së bashku për ta zgjeruar mbështetjen e zhvillimit të komunitetit lokal përtej reformave të tokës bujqësore.

Në maj, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së

Ujërave (MBPEU) njoftoi se 250 gra prodhuese bujqësore do të marrin mbështetje financiare për fuqizimin e biznesit të tyre, përmes masës 115 për mbështetjen e grave prodhuese bujqësore në kuadër të programit nacional për bujqësinë dhe zhvillimin rural (2018-2022) Me mbështetjen e **UN Women** nën projektin e buxhetimit të përgjigjshëm ndaj gjinisë, grupi punues për barazinë gjinore në MBPEU e mbështeti zhvillimin e kësaj mase, e cila është e parë që siguron mbështetje financiare për të gjitha gratë prodhuese bujqësore, të regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

Nën projektin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor të UN Women, vetë UN Women dhe Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) në Maqedoninë e Veriut do të nënshkruajnë një Memorandum Mirëkuptimi për mbështetjen e EShR-së për fuqizimin e kapaciteteve të tij për barazinë gjinore, buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, si dhe në zhvillimi i mjeteve dhe metodologjive për realizimin e auditimeve gjinore.

Dhjetë komunat e reja do të mbështeten në kuadër të projektit të UN Women "Promovimi i politikave dhe buxheteve të përgjigjshme gjinore: Drejt qeverisjes transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjigjshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut", financiar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Projekti tani do të përfshijë 31 komuna.

Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hulimtim (HERA) e organizoi serinë e tretë të trajnimeve për fuqizimin e kapaciteteve të OShC-ve drejt ofrimit të shërbimeve të specializuara për të mbijetuarit e dhunës jashtë Shkupit (7-8 maj). HERA është një organizatë partnere e UN Women brenda projektit rajonal "Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve", financiar nga BE-ja.

Komisionari i Lartë i OKB-së për Refugjatët (UNHCR), partnerët e tij dhe stafi i Qendrës për praninë - Vizbeg i shënuan festat fetare së bashku me azilkerkuesit e vendosur në Qendër, duke diskutuar dhe mësuar rreth traditave lokale gjatë **Pashkëve** dhe **Ramazanit**.

Partneri i UNHCR-së, Fakulteti Juridik Justiniani i Parë dhe Qendra e ligjit për refugjatë dhe migracionin u akredituan me sukses dhe e filluan modulën e edukimit ligjor për refugjatët. Moduli përbëhet nga kurse lëndë të ndryshme: Refugjatët dhe migrantët; Ligji ndërkombëtar i refugjatëve; Ligji i BE-së për azil dhe refugjatë; Programi klinik - edukimi klinik ligjor për refugjatët; që do të zbatohet në semestrin e tretë brenda seksionit të së drejtës publike ndërkombëtare si pjesë e programit master ndërkombëtar e drejta publike, e drejta ndërkombëtare private, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe e drejta e BE-së.

Më 12 maj, **Programi i OKB-së për Zhvillim (UNDP)** dhe Qyteti i Shkupit e hapën pullazin e ri të gjelbër në Shtëpinë e Kulturës "Koço Racin", të ndërtuar si pjesë e masave prioritare të rezistencës ndaj ndryshimit të klimës, të identifikuar përmes projektit Shkup të Qëndrueshëm të UNDP-së. Pullazi i gjelbër mbulon një sipërfaqe totale prej 390 m², duke përfshirë sipërfaqet e gjelbra të ujitura, rrugicat e asfaltuara, pajisjet urbane, ndriçimin, etj. Pullazi paraqet vatër të 3,676 fidanëve, duke përfshirë pemë, shkurre dhe bar. Ka më shumë se 30 bimë të ndryshme që ofrojnë një shtëpi të sigurt për specie të ndryshme (zogj, insekte, etj.). Kjo hapësirë unike do të ulë temperaturën në qendër të qytetit, do të rrisë qëndrueshmërinë e qytetit dhe do të përmirësojë cilësinë e jetesës urbane.

UNDP-ja e ka përfunduar procesin e përzgjedhjes së thirrjes së dytë për mbështetje financiare të familjeve në Lisiçe

për t'i zëvendësuar shporetet e drurit, qymyr drurit, vajit të papërpunuar ose ngrohës së mbeturinave me sisteme më të pastra të ngrohjes, me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit në Shkup. 81 familje u identifikuan si të përshtatshme. Familjet e zgjedhura do t'i nënshtrohen ndërhyrjeve me efikasitet energjetik në verën dhe vjeshtën e vitit 2021. Modeli i kriterëve të përzgjedhjes u zhvillua në konsultim me ekspertë të fushës dhe kryesisht synonte kategoritë e cenushme të qytetarëve. Prandaj, nuk ishte parashikuar asnjë opsion i bashkëfinancimit. Përveç kësaj, thirrja përcakton vetëm dy grupe masash, të cilat do të mbështeten financiarisht: zëvendësimi i pajisjeve të vjetra joefikase të ngrohjes me ato të reja dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve prej druri me opsione më efikase të energjisë.

UNDP e shpalli zbatimin e aplikacionit të parë tekst verbal për gjuhët maqedonase dhe shqipe i krijuar si një mjet për personat me shikim të dëmtuar. Produkti elektronik i sapo prezantuar po zhvillohet për pajisjet desktop dhe celular përmes një partneriteti mes UNDP-së, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe Shoqatës nacionale të personave me dëmtim të shikimit. Kjo do t'i ndihmojë personat e verbër dhe personat me dëmtim të shikimit, ta përpunojnë me sukses informacionin e shkruar dhe të lundrojnë më lehtë në hapësirat digjitale. Versioni përfundimtar i produktit pritet të lançohet këtë verë.

Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) në Maqedoninë e Veriut i mbështeti dy iniciativat e drejtuara kah të rinjtë, rinovimi i urës në Runicë dhe hapja e qendrës kulturore të të rinjve në Sllupçan. Të dy iniciativat u implementuan nga të rinjtë e Lipkovës përmes projektit Mbështetje për të Rinjtë, financiar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Jeta e nxënësve dhe mësuesve në fshatin rurale të Runicës është transformuar nga një urë e re që shtrihet në fshatin e ndarë nga një lumë. Ata janë mirënjohës që tani mund të lëvizin në mënyrë të sigurt dhe të shpejtë përtej lumit, i cili paraqiste sfida dhe rreziqe të shumta në të kaluarën. Qendra kulturore e të rinjve shpresojmë se do t'i rrisë mundësitë e punësimit për të rinjtë duke mësuar aftësi për të shkruar dhe rifilluar intervistat; të rinjtë do të përfshihen në komunitet, i cili, nga ana tjetër, do ta nxisë dhe promovojë angazhimin qytetar. Por qëllimi më i madh është që ata të kalojnë kohë me të rinjtë e tjerë në një hapësirë jo-gjyqësore, ku ndihen të sigurt, duke i ndihmuar kështu të zhvillojnë aftësitë e tyre drejtuese

Programet e përbashkëta të OKB-së

“Ndërtimi i shoqërive diversive – Barazia dhe inkluzioni i personave me aftësi përmes reformave sistematike”

Me synim të ndryshme si një ndryshim transformues me ndikim real në jetën e njerëzve, familja e Kombeve të Bashkuara në Maqedoninë e Veriut ka punuar me partnerë nacionalë për të ndërtuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme: një shoqëri ku pasuria dhe diversiteti respektohen plotësisht dhe ku të gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, gëzojnë të drejtat dhe mundësitë barabarta për të përparuar. **Dekada e veprimit për Objektiva e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)** bën thirrje për ta përshpejtuar progresin dhe përpjekjet për ta përbushur agjendën ambicioze, universale dhe gjithëpërfshirëse të vitit 2030. Përfshirja sociale, ekonomike dhe politike e të gjithëve, dhe çrënjësja e pabarazive të shumëllojshme dhe kryqëzuese që shpesh prekin njerëzit me aftësi të kufizuara janë pjesë përbërëse e këtij qëllimi.

Në atë frymë, Ekipi i OKB-së në vend (UNCT) filloi një program të ri të përbashkët, të financuar nga Partneriteti i OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Fondi i Mirëbesimit me Shumë Partnerë (UNPRPD MPTF), i cili synon avancimin e zbatimit të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (KDPAK) dhe **Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm OZHQ**, që e përfshijnë aftësinë e kufizuar në vend. E përcaktuar në qasjen e bazuar në të drejtat e aftësisë së kufizuar, ajo përqipet të thellojë partneritetin midis agjencive të OKB, qeverisë, organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese të të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile me të gjerë për ta dhënë premtimin kolektiv, që askush të mos lihet pas.

Udhëhequr nga **Strategjia e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen e Aftësisë së Kufizuar (UNDIS)**, OKB-ja ka hartuar ndërhyrje sistematike dhe të qëndrueshme që i përgjigjen kontekstit nacional dhe përparësive, të harmonizuara me Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK) dhe standardet ndërkombëtare. Programi do të përqendrohet në fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese si bartës të të drejtave dhe agjentë për ndryshim, dhe në rritjen e kapacitetit të qeverisë për t'i hequr pengesat që e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri.

Përmes një përqasjeje me shumë aktorë dhe ndër-sektoriale, OKB-ja do t'i përkthejë parakushtet strukturore për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në politika, sisteme dhe shërbime. Këto parakushte e përfshijnë barazinë dhe mosdiskriminimin, shërbimet e binjakëzimit, qasshmërinë, pjesëmarrjen efektive të personave me aftësi të kufizuara, buxhetimin dhe menaxhimin gjithëpërfshirës të aftësisë së kufizuar, dhe llogaridhënia e qeverisjes. Për më tepër, do të adresohen të drejtat dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara dhe të nëpërfaqësuar të personave me aftësi të kufizuara, pabarazia gjinore dhe të drejtat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, që ka të ngjarë të lihen pas.

Programi i plotë do të zhvillohet nga mesi i korrikut, bazuar në boshllëqet dhe mundësitë e identifikuara gjatë punëtorisë hyrëse dhe analizës së situatës. Trajnimi shtatë-ditor hyrës, i mbajtur nga 18 deri më 25 maj, kontriboi në ngritjen e mirëkuptimit dhe njohurive të KDPAK-së mbi OZHQ-të përfshirëse të aftësisë së kufizuar midis 50 pjesëmarrësve, që i përfaqësojnë organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe protagonistët tjerë kryesorë. Analiza kontekstuale do të përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna, për t'i identifikuar nevojat specifike dhe për ta formësuar programin e plotë. Ajo

do t'i përshkruajë objektivat e programit, aktivitetet specifike, prodhimet dhe rezultatet që do të arrihen, si dhe strukturën e partneritetit me shumë aktorë që do ta drejtojë zbatimin e programit në dy vitet e ardhshme.

Në të gjitha këto faza të programimit dhe zbatimit të përbashkët, OKB-ja do të vazhdojë të angazhohet në mënyrë proaktive me një gamë të gjerë të palëve të interesuara, përfshirë të gjitha degët dhe nivelet e qeverisë, institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut, OPAK-të, ofruesit e

shërbimeve dhe shoqërinë civile. Gjithashtu do të konsultohen palët e tjera të interesuara si sektori privat, bota akademike dhe partnerët ndërkombëtarë, me qëllim të sigurimit të një qasje të të gjithë shoqërisë. Kryesisht, personat me aftësi të kufizuara në diversitetin e tyre të plotë do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në ndarjen e përvojave të tyre të jetuara dhe nevojave thelbësore për jetën e tyre të pavarur dhe dinjitoze dhe përfshirjen, që programi kërkon të promovojë në vend.

NË FOKUS

Avancimi i barazisë gjinore ose qëndrimi i rezervuar?

Kriza COVID-19 ka qenë e paimagjinuar për sa i përket ashpërsisë së saj. Çfarë do të thotë për barazinë gjinore?

Pandemia ka ndikuar në çdo segment të jetës, duke i dhënë shumë mësimë njerëzimit. Njëra tregon sesa mbetet e ngulitur thellë pabarazia gjinore në shoqëritë tona dhe sa e lehtë mund të jetë ngecja, pavarësisht fitimeve tashmë të arritura.

Vlerësimi i shpejtë i gjinisë (VShGj) i OKB-së për Maqedoninë e Veriut zbuloi se COVID-19 kishte ndikim joproporcional ndaj grave dhe burrave në vend. Në mënyrë të veçantë, gratë kaluan më shumë orë në aktivitetet të papagurara shtëpiake dhe të kujdesit, ndërsa një në tre gra deklaroi se kishte vështirësi të paguante për ushqim, produkte higjienike, qira dhe shërbime komunale.

Cili është ndikimi ndaj garave në tregun e punës?

Kriza shëndetësore dhe masat për mbrojtje të shëndetit të njerëzve çuan në një rënie të aktivitetit ekonomik në Maqedoninë e Veriut. Duke u përqendruar në mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e përhapjes së virusit, Qeveria, si shumë qeveri të tjera, zgjodhi disa masa të rrepta, siç ishin mbyllja e kufijve tokësorë, aeroporteve, restoranteve dhe kafeneve, kufizimi i evenimenteve publike, mbyllja e shkollave dhe kufizimi i lëvizjes.

Zvogëlimi i prerë i aktivitetit ekonomik ndikoi në tregun e punës: duke u kthyer papunësinë e përgjithshme në një trend në rënie në gjysmën e dytë të vitit, ndonëse u pasua me tendencë të rritura të pasivitetit. Shkalla e papunësisë për gratë në vitin 2020 ka rënë pak më poshtë së 16% krahasuar me 18,4% në vitin 2019, megjithatë pasiviteti gjinor u rrit për 2,1% në vitin 2020 krahasuar me 1,8% për burrat.

Pandemia ka sjellë një ndryshim të madh në mënyrën e punës, me punëdhënësit dhe punëtorët që kalojnë kryesisht në tele-punë. Sipas VShGj-së, ky ishte rasti me 35% të grave të punësuar, të anketuara krahasuar me 23% të burrave.

Si i mori në konsideratë përgjigja e Qeverisë ndaj COVID-19 nevojat e ndryshme të grupeve të ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve?

Qeveria rialokoi mjete buxhetore për ta mbështetur stabilitetin ekonomik të vendit. Deri në mes të dhjetorit 2020 u miratuan katër pako anti-krizë, të cilët përmbajnë 70 masa, që arrinin në rreth 10% të BPV-së së vitit 2020.

Ndonëse ligji për mundësitë e barabarta të grave dhe burrave kërkon zbatimin e politikëbërjes dhe buxhetimit të përgjegjshëm ndaj gjinisë, megjithatë nuk ka asnjë provë që analiza dhe vlerësimet gjinore ishin kryer para hartimit të masave.

Pandemia i goditi më shumë vendet e punës të mbajtura nga gratë, duke demonstruar ndjeshmëri më të lartë të tyre, edhe pse masat anti-krizë vunë në dispozicion subvencione dhe parandaluan më shumë humbje potenciale të vendeve të punës të grave sesa të burrave. Mesatarisht, gratë përdorën 47% të subvencioneve të pagave për punonjësit gjatë periudhës prill-qershor (2020). Pjesa e grave, që marrin përfitime të papunësisë u rrit nga 52% në 56% në tetor 2020, për shkak të humbjeve më të larta të punës nga gratë.

Pjesa e grave pjesëmarrëse në programet aktive të tregut të punës ka rënë në 43,8% krahasuar me 52,5% në vitin 2019. Për më tepër, pjesa e grave që morën mbështetje për vetë-punësim (mbështetje për bizneset fillestare) në vitin 2020 u ul krahasuar me vitin e kaluar (nga 33,3% në 30,9%).

Edhe pse kriteret e pranueshmërisë për marrjen e të ardhurave minimale të garantuara (NMG) u ndryshuan për të siguruar një mbulim më të madh, pjesa e grave që marrin përfitimin mbeti e njëjtë si në vitin 2019 (35% e numrit të përgjithshëm të familjeve), ndërsa numri i përgjithshëm shfrytëzuesve të NMG-së u rritën për 14%.

Kriza e COVID-19 i ka ekspozuar dobësitë kryesore në sistemet e qeverisjes dhe i ka përkeqësuar pabarazitë ekzistuese, duke ndikuar ndryshe tek gratë dhe burrat. Kur merren parasysh pabarazitë ekzistuese gjinore në ekonomi, ekziston rreziku që pasojat e pandemisë ta përkeqësojnë pozicionin ekonomik të grave, veçanërisht atyre të grupeve të cënueshme.

Në rindërtimin e së ardhmes ka mundësi për t'i adresuar pabarazitë e vazhdueshme gjinore. Integrimi i gjinisë në proceset e politikëbërjes dhe buxhetimit të qeverisë, veçanërisht në kohë pandemike, është thelbësore për arritjen dhe përparimin e barazisë gjinore.

Për më shumë informacione, shikoni raportin e UN Women <https://bit.ly/3sUNJ2F> "Analiza e zgjedhjeve të buxhetit në një kohë pandemie: Avancimi i barazisë gjinore apo qëndrimi i përmbajtur?"

The latest version of the Sustainable Development Bulletin is available on UN North Macedonia website. For additional information, please contact rc-northmacedonia@un.org. Produced by the UN Resident Coordinator's Office in North Macedonia | 10 June 2021

www.un.mk